



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
ASAMBLEJA E AKSIONERËVE  
“ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY” SH.A.

VENDIM

Nr. 2 datë 27.06.2024

MBI  
CAKTIMIN E AUDITUESIT LIGJOR  
PËR VERIFIKIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT DHE VERIFIKIMIN  
SHLYERJES TËRËSISHT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË  
“ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY” SH.A.

Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” , përfaqësuar nga Aksioneri i vetëm i Shoqërisë, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2024 ka per rend dite :

1. Caktimin e Audituesit Ligjor per verifikimin e zmadhimit të kapitalit me vlerën 11.900.000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë sipas vendimit te Asamblese se Aksionereve nr.8 date 05/06/2023.
2. Gjithashtu audituesi ligjor do te verifikoj dhe shlyerjen e vleres prej 7,500,000 leke te ngeluar pa shlyer nga shuma 10,000,000 leke si dhe shlyerjen e shumes se 11,900,000 leke per rritjen kapitalit të shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a per.

Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” , përfaqësuar nga Aksioneri i vetëm i Shoqërisë mbështetur në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Statutin e Shoqërisë Aksionare bazuar ne rendin e ditës:

VENDOSI:

1. Të emëroj Auditues Ligjor shoqërine MAZARS shpk për verifikimin e zmadhimit të kapitalit me vlerën 11.900.000 lekë sipas vendimit te Asamblese se Aksionereve nr.8 date 05/06/2023.
2. Te emeroj shoqërine MAZARS shpk në cilesin e Audituesit Ligjor per verifikimin e shlyerjes se shumes 7,500,000 leke te ngeluar pa shlyer nga shuma 10,000,000 leke si dhe shlyerjen e shumes se 11,900,000 leke per rritjen kapitalit të shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a

3. Audituesi Ligjor të hartojë raportin përkatës dhe t'a paraqesë atë përpara Asamblesë së Aksionerëve.
4. Ngarkohet shoqëria "Albanian Seaports Development Company" sh.a për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR AUTORITETIN PORTUAL DURRËS**  
**AKSIONERI I VETËM I SHOQËRISË**

**Pirro VENGU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
ASAMBLEJA E AKSIONERËVE  
“ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY” SH.A.**

**VENDIM**

Nr. 03 datë 19.07.2024

**MBI**

**“MIRATIMIN E RAPORTIT TË RITJES SË KAPITALIT DHE SHLYERJES  
SË AKSIONEVE” TË AUDITUESIT LIGJOR FORVIS MAZARS SH.P.K”**

Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” , përfaqësuar nga Aksioneri i vetëm i Shoqërisë, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2024 ka për rend dite :

1. Miratimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë me 11,900,000 lekë (njëmbëdhjetë milion e nëtëqind mijë lekë) duke emëtuar 1,190 aksione (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) aksione të reja të cilat janë shlyer plotësisht nga aksioneri i vetëm.
2. Miratimin e raportit të rritjes së kapitalit dhe shlyerjes së aksioneve të Audituesit Ligjor FORVIS MAZARS sh.p.k;

Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë “Albanian Seaports Development Company”, përfaqësuar nga Aksioneri i vetëm i Shoqërisë mbështetur në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Statutin e Shoqërisë Aksionare bazuar në rendin e ditës:

**VENDOSI:**

1. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 11,900,000 lekë (njëmbëdhjetë milion e nëtëqind mijë lekë) duke emëtuar 1,190 aksione (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) aksione të reja të shlyera plotësisht nga aksioneri i vetëm Shoqëria “Autoriteti Portual Durres”. Mbas kësaj rritje kapitali i shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” nga 10,000,000 bëhet 21,900,000 lekë dhe numri i aksioneve nga 1000 aksione rritet dhe me 1,190 dhe bëhet 2,190 aksione me vlerë nominale 10,000 lekë/aksion.
2. Kapitali mbas rritjes zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm shoqëria “Autoriteti Portual Durres”.

3. Të miratoj raportin e rritjes së kapitalit dhe shlyerjes së aksioneve të shoqërisë audituese MAZARS shpk e cila ka verifikuar rritjen e kapitalit dhe shlyerjen e shumës 7,500,000 lekë të ngeluar pa shlyer nga shuma 10,000,000 lekë si dhe shlyerjen e shumës së 11,900,000 lekë të emëtuar rrishtas për rritjen e kapitalit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR AUTORITETIN PORTUAL Durrës**

**AKSIONERI I VETËM I SHOQËRISË**

**Pirro VENGU**

